

VENDIM
Nr.78, datë 7.2.2007

PËR MASËN, KRITERET DHE PROCEDURAT E PËRFITIMIT TË NJË PAKETE TË
VEÇANTË HIGJIENO-SANITARE, PËR INVALIDËT PARAPLEGJIKË DHE
TETRAPLEGJIKË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 9 të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000 "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar, dhe të nenit 12 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007", me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe të Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të cilët e kanë përfituar këtë status me vendim të komisionit mjekësor të përcaktimit të aftësisë për punë (KMCAP) dhe që vlerësohen se kanë humbje të plotë të sensibilitetit dhe të motorikës nga niveli i dëmtimit, poshtë, në të dyja anësitë, përfitojnë një pagesë shtesë, në masën 9 000 (nëntë mijë) lekë në muaj, për mbulimin e paketës së domosdoshme me materiale të veçanta higjieno-sanitare.

2. Pagesa shtesë, që përfitohet sipas pikës 1 të këtij vendimi, tërhiqet në zyrën e njësisë së qeverisjes vendore, ku paraplegjikët dhe tetraplegjikët përfitojnë pagesën e aftësisë së kufizuar.

3. Për të përfituar këtë pagesë invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë duhet të dalin në KMCAP, pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2007, zëri "Transferta të familjeve dhe të individëve", grupi 25, titulli 064, kapitulli 1, artikulli 606, miratuar për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

5. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha